



Kosovo Local
Government
Institute



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Analizë

Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna

**(Sfidat në zbatimin e Udhëzimit Administrativ për
standardet minimale të konsultimit publik në Komuna)**

Aktiviteti realizohet në kuadrin e programit 'Dialogu për Komunat Evropiane' (DEM), i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

Prishtinë 21 shkurt 2022

Qëllimi i projektit

Përmes kësaj analize, synohet që të zhvillohet një hulumtim dhe të përpilohet një raport lidhur me vlerësimin e shkaktarëve për moszbatimin e plotë të Udhëzimit Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në komuna dhe t'i ofrojë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), rekomandime të vlefshme për hapat që duhet të ndërmarr në përmirësimin e kësaj gjendje.

Metodologjia

Zbatimi i projektit është bërë duke aplikuar një kombinim të metodave për të identifikuar dhe raportuar pengesat në zbatimin e këtij udhëzimi. Qëllimi kryesor është që të marrim përvojat e zyrtarëve komunalë në zbatimin e këtyre kërkesave dhe cilat janë pengesat që u janë shfaqur në përdorimin efektiv.

Procesi është zbatuar, fillimisht duke analizuar kuadrin ligjor dhe praktikat ndërkombëtare për përfshirjen e qytetarëve në konsultimin publik, dhe më pastaj janë zhvilluar intervistat me zyrtarët komunalë në katër komuna, Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Për më tepër janë zbatuar këta hapa:

1. Analizën e kuadrit ligjor në fushën e transparencës, qasjes në dokumente zyrtare dhe të konsultimit publik;
2. Praktikrat ndërkombëtare, me theks parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
3. Intervistat me zyrtarët kompetentë komunalë në komunat e përzgjedhura sipas vlerësimit të bërë në raportet e organizatave të shoqërisë civile, përmes përzgjedhjes së atyre të suksesshme, pjesërisht të suksesshme dhe që kanë dështuar në procesin konsultativ. Lidhur me këtë dokument kyç është cilësuar edhe Raporti i MAPL-së për periudhën janar-qershor 2021;
4. Qëndrimet e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
5. Një debat i veçantë është organizuar lidhur me UA nr. 06/2018 i MAPL-së për standardet minimale të konsultimit publik në komuna;
6. Zhvillimi i raportit final për t'i vendosur shkaktarët për moszbatim efektiv;
7. Vendosja e rekomandimeve për MAPL-në për hapat që duhet të ndërmarrë për përmirësimin e situatës.

HYRJE

Llogaridhënia e institucioneve publike kundrejt publikut mund të zbatohet, përveç tjerash, duke qenë transparente dhe duke i përfshirë qytetarët në mënyrë pro aktive në procesin vendimmarrës, jo vetëm kur zgjedhin përfaqësuesit e tyre, por sidomos përmes procesit të konsultimit. Vendimmarrja e mirë sigurohet vetëm me pjesëmarrjen e publikut dhe kjo realizohet përmes bashkëpunimit të institucioneve me qytetarët. Kështu, siguron besimin e publikut në institucione, minimizon shkallën e gabimit në vendosjen e prioriteteve dhe ofron bazë të mirë për plotësimin e nevojave të komunitetit.

Duke respektuar dhe zbatuar parimin e transparencës, institucionet u mundësojnë qytetarëve qasje në informatat të cilat janë thelbësore për të kërkuar llogari dhe për të ekspozuar keqpërdorimet eventual me të mirat e përbashkëta.

Korniza ligjore aktuale në Kosovë ka përqafuar praktikat më të përparuara lidhur me pjesëmarrjen e publikut në punën e organeve të vetëqeverisjes lokale. Duke qenë promovuese dhe inovatore, MAPL-ja ka zhvilluar një sërë politikash dhe legjislacione dytësor, por edhe platforma konkrete siç janë: ueb - faqet e strukturuar dhe kanalet e komunikimit të internetit mes institucioneve dhe publikut për të inkurajuar, mbështetur, por edhe prezantuar obligimet e organeve komunale, për të siguruar minimumin e transparencës së tyre kundrejt publikut.

Zhvillimi i hovshëm teknologjik ka ndryshuar në thelb qasjen e publikut karshi organeve të zgjedhura, duke i bërë këto të fundit më të ekspozuara para tyre. Ky zhvillim i hovshëm ka shtruar edhe nevojën për të vendosur mbrapa disa nga praktikat tradicionale dhe duke i zëvendësuar ato me mjete më të shpejta dhe efektive, siç janë: platformat e ndryshme të komunikimit masiv apo përdorimit të mediave sociale. Së këndejmi, edhe komunat kanë në mundësi që shumë shërbime t'i ofrojnë shpejt dhe me kosto më të mira përmes platformave online që nga komunikimi deri tek shërbimet e ndryshme administrative.

Sot, publiku kosovar (organizatat joqeveritare, mediat dhe shoqatat) realizojnë hulumtime dhe publikime nga më të ndryshmet lidhur me performancën e komunave për të përfshirë në procesin vendimmarrës qytetarët e tyre dhe duke i bërë transparente vendimet e tyre. Të gjitha këto, komunat dhe shoqatat, kanë pasur në krah përmes ndihmës financiare apo asistencës teknike projekte ndërkombëtare që i kanë dhënë një impuls zhvillimit të hovshëm të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Një vlerësim objektiv aktualisht pothuajse është i pamundshëm, pasi duhet pasur në konsideratë kufizimet që ka sjellë pandemia për te palët: institucionet lokale por edhe për qytetarët që të tregojnë aktivizimin e tyre.

Në një masë të konsideruar, përkundër që transparenca është një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë, nuk konsiderohet si detyrim nga ana e autoriteteve lokale për të ndarë informacione me qytetarët, për të marrë vendime të drejta dhe të bazuara në informacion dhe ende nuk është formësuar rëndësia që kanë autoritetet lokale në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe llogaridhënie që janë komponentët më me peshë të zhvillimit të demokracisë.

Autoritetet lokale duhet në vazhdimësi të japin informacione për punën e tyre, të shfrytëzojnë mekanizma për konsultim që iu përgjigjen më së miri qytetarëve, t'i bëjnë grupet e interesuara pjesë të politikbërjes, t'u japin llogari në baza të rregullta si në fazën e planifikimit, ashtu edhe gjatë zbatimit të këtyre politikave.

Në funksion të kësaj, cilësia e shërbimeve komunale dhe administrimi efikas i kërkesave të qytetarëve, varen edhe nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemeve të informacionit që aplikohen, teknologjitë, teknikave të konsultimit, si dhe veprimeve të tjera përcjellëse të organeve të administratës publike.

Përdorimi i ueb-faqeve është një nga mekanizmat për të mbajtur të informuar qytetarët lidhur me aktivitetet e organeve komunale. Përdorimi i tyre rregullohet me akt nënligjor të qeverisë, i cili i obligon të gjitha institucionet publike të japin informacionet për punën e organeve të tyre, shërbimeve të ofruara, përmbajtjes dhe përditësimit të dokumenteve zyrtare, informacioneve për përgjegjësitë e njësive organizative të komunave, dokumenteve financiare, prokurimit etj. Po ashtu, informacioni i publikuar në ueb faqe duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet gjuhësore.

Në vitin 2018, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ri-dizajnuar ueb-faqet e 38 komunave të cilat fillimisht ishin themeluar dhe unifikuar në 2013. Ridizajnimi mundësoi unifikimin e standardeve të publikimit të informatave, dhënien e mundësisë për aplikime online, paraqitjen e kërkesave dhe shqetësimeve në fushën e sigurisë në bashkësi, si dhe transmetimin online të mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Përveç karakterit informues të ueb-faqeve komunale, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe ndërliidhen me ueb-faqe tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë u mundëson qytetarëve të parashtrojnë online të gjitha kërkesat e tyre drejtorive përkatëse të komunës.

Në formë të përmbledhur transparenca për vendimet dhe pjesëmarrja e qytetarëve, kur merren këto vendime, duke shfrytëzuar të gjitha kanalet e komunikimit në mënyrë sa më ekonomike dhe efektive përbën qeverisjen e mirë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Argumenti kryesor i zyrtarëve komunalë është që përfitimi që vjen kur qytetarët janë të kënaqur shkon fillimisht në interes të tyre, prandaj qëllimi i tyre nuk është të minimizojnë ndikimin e përfshirjes së publikut në proceset konsultative. Ballafaqimi me statistikën e publikuar se administratat komunale nuk kanë arritur mjaftueshëm, përkundër që kanë përfitimet e drejtpërdrejta, sjell argumentet shtesë të cilat shtrihen gjerësisht në disa drejtime dhe për të cilat zyrtarët kompetent komunalë kanë argumentet e tyre. Në mënyrë të përmbledhur këto argumente puqen në së paku dy sfida kryesore. E para, se kërkesat ligjore janë të shumta, nevojat e qytetarëve janë shumë më të mëdha se kapacitetet e komunave, deri tek shtrëngimet financiare që kanë për t'i zbatuar më mirë kërkesat e qeverisjes së mirë dhe transparente. Dhe së dyti, që pjesëmarrja e qytetarëve është minimale dhe përkundër organizimit të mirë nuk shprehin interesim për pjesëmarrje.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në raportin Janar-Qershor 2021, ka vlerësuar nivelin e transparencës në komunat e Republikës së Kosovës, duke bërë krahasimin e aktiviteteve të komunave me detyrimet ligjore për informimin e duhur të qytetarëve lidhur me vendimet, planet, dokumentet strategjike, aktivitetet financiare dhe të prokurimit, si dhe përfshirjen e tyre në politikbërje. Raporti përmbledh edhe rezultatet e pyetësorit për nivelin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimeve publike.

Në këtë raport është evidentuar që puna e organeve të komunës ende nuk është plotësisht transparente.

Në mënyrë të vazhdueshme janë publikuar raporte të pavarura të prodhuara nga organizata të shoqërisë civile, me theks vlerësimin e organeve të komunës për transparencën e tyre karshi publikut.

Në këto raporte, një vlerësim i veçantë i është bërë aspektit financiar të komunave që ka rezultuar me ekstreme nga publikimi i tërësishëm deri tek komunat që nuk kanë publikuar asnjë dokument buxhetor dhe duke mos organizuar asnjë takim me qytetarët në kuadër të dëgjimeve buxhetore. Sa i përket prokurimit publik, ka një përparim të dukshëm lidhur me transparencën pas aplikimit të E-Prokurimit për të gjitha institucionet publike. Por, kjo është e pamjaftueshme, sepse vazhdon të jetë i cenuar integriteti, pasi komunat kanë probleme serioze në planifikimin e vlerave të kontratave publike pasi shpesh rezultojnë me lidhjen e kontratave publike që tejkalojnë vlerat e shumave të planifikuara me buxhetin komunal.

Komunat kanë para vetës detyrime ligjore për të forcuar transparencën dhe rritur volumin e konsultimeve me qytetarët, por veç detyrimit ligjor, komunat mund të mbështetën edhe në parimin e qeverisjes së mirë, kur është ka të bëjë me konsultimin publik, madje nuk mund të thuhet se ka qeverisje të mirë pa elementin e përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit. Kjo, sepse, përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, ndikon në disa drejtime, siç krijon hapësirën për vendimmarrje të përbashkët në mes institucioneve dhe qytetarëve, rrit njohuritë e qytetarëve në lidhje me mënyrën e funksionimit të komunave, bën më të lehtë monitorimin e projekteve, rrit nivelin e informimit të qytetarëve për punët publike dhe i bën projektet/investimet me të qëndrueshme.

BAZA LIGJORE

E drejta për të zgjedhur dhe e drejta për t'u zgjedhur është vendosur në themelet e sistemit demokratik në vend. Por, kjo nuk është konsideruar e mjaftueshme pa e vendosur në epiqendër parimin e transparencës dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin vendimmarrës qeverisës. Është konkluzion unik që Kosova ka zhvilluar një bazë ligjore të përparuar për përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Përkundër kësaj dhe përparimit të ndjeshëm, vlerësimet e institucioneve përkatëse, të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave si dhe të mekanizmave ndërkombëtarë, vlerësojnë se situata është ende e brishtë dhe institucionet publike nuk kanë pasur sukses për përfshirjen e qytetarëve në proceset e rëndësishme vendimmarrëse për jetën publike.

Në pajtim me autorizimet e dhëna përmes Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka nxjerr tri (3) Udhëzime Administrative shumë të rëndësishme për të promovuar dhe rregulluar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në komuna.

Këto udhëzime në mënyrë komplementare rregullojnë procesin e vendimmarrjes në komuna përmes procesit transparent, konsultativ dhe të qashtë për qytetarët në burimet e shkruara të komunës që janë pronë publike. Derisa udhëzimi i parë rregullon obligimet e organeve të komunës në ngritjen e strukturave në vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin vendimmarrës, udhëzimi i dytë rregullon strukturat dhe procedurat brenda administratës dhe organeve të komunës për të inkurajuar dhe promovuar përfshirjen e qytetarëve në procesin konsultativ për politikat lokale apo aktet tjera normative. Udhëzimi i tretë detajon procedurat dhe afatet e qasjes në dokumentet zyrtare dhe publikimin e tyre në mjetet e komunikimit zyrtar të komunës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 45 i ka garantuar të gjithë qytetarëve mbi moshën 18 vjeç, të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje dhe të drejta zgjedhore dhe po ashtu ka garantuar pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike. Për me tej, Kushtetuta në kapitullin X - Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial ka garantuar se vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë dhe që vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike. Neni 124 në këtë kapitull siguron, përveç tjerash, pjesëmarrje aktive të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Këshilli i Evropës, Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale

Qëllimi i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale

Qëllimi i Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokaleii është të plotësojë mungesën e standardeve të përbashkëta evropiane për matjen dhe garantimin e të drejtave të organeve lokale, të cilat janë më pranë qytetarëve dhe t'i japin qytetarëve mundësinë

e pjesëmarrjes efektive në marrjen e vendimeve me ndikim për interesin e përgjithshëm. Karta i angazhon palët të zbatojnë rregullat bazë që garantojnë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të organeve vendore. Ajo demonstroi në nivelin evropian vullnetin politik, për t'i dhënë jetë në të gjitha nivelet e administrimit territorial, parimeve të mbrojtura që prej miratimit të saj nga Këshilli i Evropës.

Parimi i transparencës sipas Kartës

Qeverisja ka një dimension të dyfishtë politik dhe teknik. Në dimensionin e saj politik, ajo kërkon pjesëmarrjen, vendimmarrjen dhe udhëheqjen. Në dimensionin e saj teknik, ajo kërkon vlerësim të nevojave, planifikim, negocimin e kontratave, mekanizmave të kontabilitetit, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit. Të dy dimensionet kërkojnë transparencë. Në mënyrë që transparenca të paraqitet në mënyrë efektive në qeverisjen lokale duhet të plotësohen disa premisa. Një nga premisat e para lidhur me këtë çështje është pasja e sistemit demokratik të suksesshëm. Për të pasur një sistem të tillë, duhet të funksionojë qeverisja e mirë në të gjitha nivelet.

Pra, qeverisja dhe në veçanti qeverisja e mirë, ka të bëjë edhe me mënyrat efektive të angazhimit të vazhdueshëm të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë. Prandaj, qeverisja është e lidhur ngushtë me demokracinë dhe rolin qendror që qytetarët duhet të luajnë në secilin sistem të qeverisjes efektive.

Transparenca është element përbërës i demokracisë lokale dhe u ndihmon qytetarëve që t'i njohin, kuptojnë dhe miratojnë ose plotësojnë politikën, procedurat dhe veprimet e komunës së tyre. Elementet më të rëndësishme të transparencës përfshijnë takime të hapura dhe pjesëmarrjen publike, paraqitjen e pasqyrave financiare, lirinë e informimit, llogaridhënien, shqyrtimin buxhetor dhe procedurat e auditimit.

Transparenca në nivelin lokal paraqitet si mekanizëm që t'iu ndihmojë autoriteteve lokale t'i publikojnë punët e tyre, t'i kryejnë si duhet veprimet e tyre dhe të jenë të përgjegjshëm për aktivitetet e tyre të përditshme. Është forcë shtytëse për ndërtimin e qeverisjes së mirë, kështu që ndihmon në promovimin e zhvillimit lokal, në ngritjen e rritjes ekonomike dhe zgjerimin e kohezionit social.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Ligji për Vetëqeverisje Lokale iii në Kreu-n IX, Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve, ka përcaktuar kërkesat minimale ligjore sa i përket procesit të konsultimit me qytetarët. Neni 68 obligon komunat që të mbajnë periodikisht së paku dy herë në vit takime publike, në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Në takimet e tilla, përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunalë. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t'i

informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik dhe lidhur me këtë kanë në obligim që të nxjerrin Rregulloren komunale për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

Përmes këtij ligji është siguruar se çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Neni 69 dhe neni 70 kanë siguruar të drejtën e peticionit pranë organeve komunale, respektivisht të iniciativave të qytetarëve për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim. Ligji për Vetëqeverisje Lokale në nenin 72 ka paraparë të drejtën e iniciativës për shkarkimin e kryetarit të komunës, ndërsa në nenin 73 obligon komunën për themelimin e komiteteve këshillëdhënëse sektoriale, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe që në përbërjen e tyre duhet të jenë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike ivgaranton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike dhe zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga institucionet publike.

Ky ligj obligon çdo institucion minimalisht të caktojë zyrtarin për komunikim me qytetarë pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare duhet të vlerësojnë se cila është njësia përkatëse brenda institucionit publik që duhet ta ketë dokumentin e kërkuar.

UA nr. 06/2018 i MAPL-së për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna^v.

Me këtë udhëzim është rregulluar që autoritetet lokale kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikbërjes në komuna, të promovojë transparencë komunale, si dhe të ndikojë në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm. Përmes këtij udhëzimi administrativ janë përcaktuar rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës, dhe së dyti, që këto procedura të aplikohen në mënyrë uniforme në gjitha komunat, duke siguruar uniformitetin e nevojshëm për pjesëmarrjen qytetare dhe të ndikojë njësojë në forcimin e parimit të transparencës dhe demokracisë.

Rregullore (MAPL) nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës^{vi}

Kjo rregullore përcakton unifikimin e teknikës juridike, strukturës dhe procedurës së hartimit, si dhe publikimit të akteve të komunës. Dispozitat e kësaj rregullore janë të detyrueshme për të gjitha organet e komunës që hartojnë, miratojnë dhe publikojnë aktet e tyre. Secila komunë përmes këtij akti obligohet të emërojë një zyrtar përgjegjës që bashkërendon procesin e hartimit të akteve normative me të gjitha njësitë brenda komunës, të cilat janë të obliguara të ofrojnë ndihmë sipas kërkesave të tij, si dhe sipas nevojës, bashkërendon punën me Zyrën ligjore dhe njësitë tjera përkatëse për integritet evropian dhe atë të financave.

Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane^{vii}

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që të rregullojë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në ushtrimin e disa aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës. Udhëzimi përcakton themelimin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës me Këshillat Lokale për çështjet e interesit publik.

Në qendër të rregullimit janë Këshillat lokale që nënkuptojnë trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Bashkëpunimi i komunës me këshilla lokale bëhet për çështjet që janë në kompetencë të komunës dhe që kanë të bëjnë me planifikimin urban dhe rural, furnizimin me ujë, shëndetësinë publike, mbrojtjen lokale të ambientit, turizmin dhe hapësirave publike, aktiviteteve kulturore dhe sportive etj.

Rregulloret komunale

Në nivel komunal të legjislationit, komunat janë të udhëzuara që të nxjerrin Rregulloret Komunale për Transparencë, përmes të cilave do të promovojnë punën transparente të organeve dhe të administratës së komunës. Këto rregullore të adaptuara kanë përqafuar në mënyrë uniforme shumicën e procedurave, llojeve dhe afateve në procesin e konsultimit publik.

GJETJET KRYESORE

Duke i marrë të mirëqena, në mënyrë të arsyeshme referencat se ka shumë hulumtime nga organizatat joqeveritare, që kanë rezultuar se përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje nuk është e kënaqshme si pasojë mos organizimit të duhur të diskutimeve nga ana e institucioneve, mos informimi i duhur i qytetarëve edhe për debatin edhe për fushat/projektet/çështjet që kanë për t'u diskutuar, besimi i vogël që diskutimet/debatet e tilla kanë për të ndikuar pozitivisht në jetën e qytetarëve,

mosinteresimi edhe i vetë qytetarëve për pjesëmarrjeje, por edhe si pasojë e mungesës së krerëve të institucioneve në këto debate.

Këto të gjetura janë raportuar edhe në raportet periodike të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe janë konfirmuar nga vizitat në komunat e përzgjedhura. Si konstante rreth 65% e qytetarëve janë deklaruar se nuk kanë vizituar asnjëherë ueb-faqen e komunës dhe nga kjo rreth 41% e kanë vizituar për konkurset e punës. Përqindja më e ultë rreth 13% kanë vizituar ueb-faqen për t'u informuar rreth zhvillimeve në komunë.

Është evidente që komunat janë aktive në komunikim me qytetarët dhe kjo viteve të fundit është dinamizuar shumë. Komunikimi ndodh përmes takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik, përfshirjes aktive të qytetarëve, grupeve të interesit, tryezave të përbashkëta, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe çfarëdo metode tjetër me të cilën transparenca do të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale. Ajo që i bën joefektive në mënyrë të mjaftueshme, është fakti se ky dialog është i pa strukturuar dhe qytetarët nuk janë përfshirë në proceset e rëndësishme të komunave, siç janë proceset e draftimit të buxhetit si dokument kryesor strategjik i komunës, ashtu edhe në diskutime për çështje të rëndësishme publike, zbatimit të projekteve, planeve si dhe projekt akteve komunale.

Në analizën e prezantuar nga MAPL-ja, dokumentohen këto konkluzione pasi në vitin 2020 vetëm 21 nga 38 komunat kishin pasur sukses të organizojnë takimet publike për dëgjimet buxhetore.

Për këtë arsye, ueb-faqet zyrtare të komunave janë platformat bazë për komunikimin e informatave për qytetarë. Por, përkundër kësaj, sipas të dhënave nga monitorimi i ueb-faqeve të komunave kemi si në vijim: 23 komuna ose 61 % e tyre kanë publikuar planin e buxhetit në pajtim me paragrafin 1 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për Transparencë, ndërsa 15 komuna ose 39% e komunave nuk e kanë publikuar planin e buxhetit për vitin 2021.

Korniza Kohore për Procesin e Konsultimit

E gjetura:

Rregulloret komunale për transparencë nuk janë në harmoni me UA nr. 06/2018 i MAPL-së për standardet minimale të konsultimit publik në komuna. Për më tepër, këto udhëzime nuk janë gjithëpërfshirëse për të hapur një perspektivë të re të dinamizimit të konsultimit publik. Si të tilla, janë në konflikt dhe shkaktojnë huti tek zyrtarët komunalë që i kanë në përdorim. UA (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna duhet ri-trajtuar në disa kërkesa që përfshihen dhe në afatet e tyre. Sipas komenteve të zyrtarëve kompetentë lokalë, pengesë në zbatim paraqet neni 6.1 pika 1.1, ku duhet zhvilluar konsultime publike për planin vjetor të punës të kryetarit të komunës. Sipas tyre, ky obligim nuk sjell ndonjë rezultat edhe pse zhvillohen konsultimet publike, sidomos te plani i punës së kryetarit, meqenëse

ky plan ndërlihet me buxhetin dhe planifikimin buxhetor, i cili paraprakisht i nënshtrohet po ashtu konsultimeve publike. Po ashtu, Neni 18 pika 1 paraqet afatin e caktuar minimal prej 30 ditësh për konsultime publike, pavarësisht llojit të dokumenteve. Ky kufizim nuk është efektiv për të gjitha llojet e dokumenteve prandaj vlerësohet se më efektive është kategorizimi i dokumenteve sipas kohës së nevojshme, varësisht nga lloji dhe kompleksiviteti i tyre.

Shkaku:

Këto rregullore janë adaptuar më herët se nxjerrja e udhëzimit dhe komunitat e pilotuara nuk kanë bërë përditësimet e tyre. Në anën tjetër, udhëzimi i ka grupuar të gjitha dokumentet në nivelin e njëjtë për nga rëndësia dhe nuk merr në konsideratë nevojat praktike kohore për t'i përkthyer në veprime konkrete.

Rekomandim:

MAPL-ja, në bashkëpunim me zyrtarët komunalë kompetentë, mund të ndërmarrë një nismë të harmonizimit të thellë dhe të rishikimit të njëkohshëm të Udhëzimit dhe Rregulloreve në fushën e transparencës dhe konsultimit publik.

Pjesëmarrja e qytetarëve – aktivizmi i tyre

E gjetura:

Komunitat nuk kanë arritur të adresojnë qartë strukturat institucionale për të siguruar transparencën dhe përkrahjen e qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrje. Nuk ka një mekanizëm efektiv me detyra të qarta në sistemin e brendshëm që adreson zbatimin efektiv të kërkesave të udhëzimit. Në anën tjetër, Udhëzimi ka një kërkesë të ngurtë për caktimin e një zyrtari për konsultim publik që nuk i jep zgjidhje nevojave, pasi në esencë, konsultimi publik, në terma administrativë dhe funksionalë është shumëdimensional dhe gjithëpërfshirës.

Shkaku:

Komunitat kanë bërë një përparim në hapjen e të dhënave në fushën e shpenzimeve buxhetore, të prokurimit publik dhe disa aspekte administrative të vendimmarrjes, duke përfshirë ekzekutivin dhe Kuvendin. Por, ka ngecje të theksuara në fushën e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe në informimin e qytetarëve lidhur me investimet publike. Zyrtarët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit publik, nuk kanë autoritetin e nevojshëm administrativ për t'i përdorur resurset komunale për këto qëllime.

Rekomandimi:

MAPL-ja në bashkëpunim me komunitat duhet të rrisin përgjegjësinë e konsultimit nga niveli teknik – administrativ në nivelin politik – strategjik. Udhëzimi Administrativ duhet ndryshuar në këtë vështrim dhe duke vendosur edhe masat stimuluese apo sanksionuese varësisht nga zbatimi i udhëzimit.

Komunikimi

E gjetura

Sipas të dhënave zyrtare, vitin e kaluar, nga 261 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave, njoftime në ueb-faqe janë publikuar për 235 mbledhje. Pra, mungojnë 26 njoftime për mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Po ashtu, në ueb-faqet zyrtare të komunave janë publikuar 827 akte të kuvendeve të komunave në krahasim me 1037 akte sa janë të aprovuara. 34 komuna ose 89% e komunave kanë publikuar aktet e kuvendeve në ueb-faqe, ndërsa 4 komuna nuk kanë publikuar asnjë akt të tillë. Sipas të dhënave nga raporti i funksionimit të komunave kemi 962 vendime të aprovuara, në krahasim me 766 vendime të publikuara, si dhe 58 rregullore të aprovuara në krahasim me 43 rregullore të publikuara.

Ajo që është më shqetësuese ka të bëjë, jo vetëm me mungesën e publikimit në terma statistikor, se sa me llojin e dokumenteve që nuk janë publikuar. Një analizë sipas metodës së rastësisë, na jep sinjale se nuk janë publikuar kryesisht vendimet me peshë më të madhe në jetën e qytetarëve.

Shkaku

Komunat nuk kanë ndërtuar sistem funksional të komunikimit dhe bashkërendimit të brendshëm. Kjo rezulton me mungesë të evidencës për dokumentet dhe proceset që duhet të publikohen. Së dyti, është evidente se problem janë publikimi i informatave të përgjithësuara, publikimi jo periodik i raporteve, mos publikimi në butonin e saktësuar për publikim, përdorimi i dokumenteve në PDF, mos publikimi i të dhënave në rrjetet sociale.

Rekomandim

Komunat duhet të shtojnë intensitetin e punës së tyre në bërjen sa më transparente të aktiviteteve të zhvilluara dhe dokumenteve publike. Komunat duhet të krijojnë mekanizma ligjorë, që qytetarëve t'ua mundësojë të jenë sa më afër informacionit. Pikëpamjet e ndryshme të publikut japin mundësinë e vërtetimit të supozimeve të administratës, duke zhvilluar politika të bazuara në të dhëna reale. Para se gjithash, komunat kanë nevojë të rishikojnë kanalet e komunikimit dhe rishikimit funksional të brendshëm dhe MAPL-ja duhet të ndërtojë projekte të veçanta që të përkrahë këtë proces përmes asistencës teknike.

Autonomia e organizimit të administratës publike

E gjetura

UA nuk ka marrë në konsideratë mjaftueshëm autonominë e organizimit të administratës komunale. Në nenin 9, përmes udhëzimit administrativ tek detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit për koordinimin e konsultimit publik është përcaktuar në mënyrë taksative një varg i detyrave të cilat nuk mund të zbatohen nëse udhëheqësit të subjektit të sektorit publik të delegojë pjesën e përgjegjësisë dhe autoritetit të tyre, duke u siguruar të jetë në pajtim me parimet e ndarjes së detyrave; të jetë i

dokumentuar, përfshirë përgjegjësinë që rrjedh nga ligjet dhe aktet nënligjore tjera; të mos shkarkojë udhëheqësin e subjektit të sektorit publik nga përgjegjësitë e tij.

Shkaku

Kufizimet buxhetore janë pengesë serioze në ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin, administrimin dhe dokumentimin e procesit të konsultimit publik. Po ashtu, udhëzimet nga Qeveria për të unifikuar në mënyrë të njëtrajtshme këtë proces, pa pasur në konsideratë specifikat e komunave apo diversitetin e organizmit dhe nevojave të tyre, nuk ka dhënë efektin e dëshiruar. Kryetarët e komunave e konsiderojnë të “realizuar” këtë detyrë duke caktuar personin përgjegjës.

Rekomandimi

MAPL-ja si liderë i politikave lokale duhet të punojë ngushtë me Ministrinë e Financave që të sigurojë që komunat kanë autonominë e mjaftueshme për ndarjen dhe alokimin e resurseve në bazë të prioriteteve dhe nevojave të tyre dhe njëkohësisht të adresojë përgjegjësinë për zbatimin e konsultimit publik tek udhëheqësit e organeve komunale dhe të minimizojë përgjegjësinë në nivel teknik.

Problemet teknike dhe përshtatshmërisë

E gjetura

Komunat ballafaqohen me probleme teknike dhe njohuri të nevojshme për t'i zgjidhur. Mungojnë udhëzimet e strukturuar në formën e procedurave organizative që udhëzojnë çfarë duhet bërë dhe autorizojnë atë se kush duhet ta bëjë. Po ashtu, sa i përket sfidave të përshtatshmërisë, nuk është përgatitur ende një përgjigje e përshtatshme për to, pasi ato kërkojnë të mësuarit si të kapërcehen konfliktet në vlerat dhe zvogëlohet apo ngushtohet hendeku midis vlerave të shpallura dhe realitetit. Kjo në masë të madhe është edhe rrjedhojë e nivelit kulturor administrativ që ka nevojë për ndryshime. Këtu, kërkohen ndryshime në vlera, sjellje apo qëndrime qoftë tek shërbyesit publikë, qoftë tek qytetarët.

Shkaku

Kultura dhe praktika organizative dhe administrative në administratën lokale, është e pamjaftueshme për të adresuar në mënyrë të suksesshme proceset e konsultimit dhe respektimin e parimit të transparencës. Në anën tjetër, publiku ka nevojë të inkurajohet për të qenë aktiv në proceset e konsultimit. Është e konfirmuar se ndryshimet kulturore e marrin kohën e tyre, por si pasojë e mungesës së projekteve konkrete administratat komunale lëvizin shumë ngadalë në këtë drejtim.

Rekomandimi

MAPL-ja duhet të konsiderojë mundësinë e organizimit të kampanjave, me qëllim edukimin qytetarë për ndikimin e tyre në procesin vendimmarrës, ndërsa për zyrtarët kompetentë, seanca për ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'i adresuar sfidat.

Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror

E gjetura

Sipas udhëzimit, komunat janë të obliguara, që në kuadër të procesit të konsultimit publik, të bëjnë publikimin e projekt propozimeve në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror. Kjo është njëra nga mundësitë që është shfrytëzuar më së paku nga ana e komunave me arsyetimin se çështjet e komunikimit të tyre me qytetarët duhet të lidhen me instrumentet lokale dhe me promovimin e instrumenteve vetanake, siç është ueb-faqja e komunës, apo kanalet tjera të komunikimit social dhe të ketë një vijë ndarëse të qartë mes promovimit të politikave lokale që atyre qendrore.

Shkaqet

Zyrtarët komunalë, argumentin e vendosin tek parimi i ekonomizimit edhe efektivitetit lidhur me publikimin në disa kanale të komunikimit, dhe së dyti, me edukimin e palëve të interesit, që zakonisht, çdo interesim i drejton tek ueb-faqja e komunës dhe jo në adresat tjera alternative.

Rekomandim

MAPL-ja të fokusojë komunikimin në instrumentet dhe mekanizmat komunalë përmes ndryshimit të legjislacionit përkatës dhe përmes ndihmës konkrete në fushën e promovimit të transparencës komunale.

Përgjegjësia për zhvillimin e konsultimit dhe ndryshimi i kornizës ligjore

E gjetura

Derisa Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik, ka përcaktuar kush është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe organizimin teknik të procesit, ka një hendek se kush është përgjegjës për zhvillimin e konsultimit. Në intervistën e zhvilluar me disa nga drejtorët kyç, merret e njëjta përgjigje, se ne kemi në komunë një zyrtar që kujdeset që të sigurohet konsultimi publik. Por, në pyetjen se si e shohin rolin e tyre në këtë proces, shprehën se janë të gatshëm të marrin pjesë, nëse kjo iu kërkohet. Në pyetjen e njëjtë për kryetarët e komunave, marrin një qasje tjetër që sipas këtyre të fundit secili drejtor është përgjegjës për fushën e vet përfshirë kërkesat për zbatimin e konsultimit publik. Kur zyrtarët kompetentë për zbatimin e procesit të konsultimit publik pyeten për përgjegjësitë e tyre, shprehen që nëse ka kërkesa nga menaxhmenti i komunës, bëjnë organizimin e tyre.

Shkaku

Adresimi i përgjegjesisë është zbritur në nivele të ulëta administrative dhe është shmangur nga organet vendimmarrëse. Politikat e shkruara mungojnë dhe udhëzimet përkatëse nuk janë të shkruara.

Rekomandimi

MAPL-ja në bashkëpunim me komunat ka nevojë të bëjnë një vlerësim të detajuar dhe varësisht nga rezultatet të bëjë rishikimin e Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik, duke e vendosur institucionin e përgjegjesisë tek organet vendimmarrëse (Kryetari dhe Kuvendi Komunal).

Kontrolli i brendshëm i rëndësishëm për transparencën

E gjetura

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) ka si synim të ofrojë siguri të arsyeshme, që fondet publike po përdoren për qëllimin e përcaktuar, në përputhje me parimet e ekonomizimit, efikasitetit, dhe efektivitetit. Zbatimi efektiv i këtij sistemi minimizon gabimet dhe krijon mundësinë e identifikimit të pikave kritike.

Shkaku

Gjatë ekzaminimit nuk është evidentuar që sistemet moderne të kontrollit të brendshëm fokusohen tek transparenca. Pra, ky mekanizëm nuk përdoret për këto qëllime dhe gjatë hulumtimit nuk kemi gjetur asnjë gjurmë që jep shpresë se ky mekanizëm do të përdoret dhe të shërbejë si një mekanizëm mbrojtës.

Rekomandimi

MAPL-ja në bashkëpunim me Njësinë Harmonizuese, në kuadër të Ministrisë së Financave, mund të organizojë një seri të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe duke vepruar kështu, të rris transparençën që e mban qeverisjen përgjegjëse kundrejt publikut që paguan taksa dhe pret të marrë shërbime.

PËRFUNDIME

- Përgjithësisht, respektimi i parimit të transparencës në nivel komunal ka shënuar progres. Po ashtu, konsiderohet se komunikimi gjatë proceseve zgjedhore është përparuar dhe ka një komunikim dhe pjesëmarrje solide të qytetarëve. Megjithatë kjo s'mund të confirmohet për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e ndryshme të konsultimit publik.

- Përfaqësuesit e zgjedhur komunalë duhet të shtojnë përpjekjet dhe kujdesin, në mënyrë që qytetarët të jenë në dijeni të proceseve konsultative dhe që me kohë kanë marr njoftimet.
- Ueb-faqet e komunave nuk janë të përditësuara dhe mungojnë shënimet më të rëndësishme për aktivitetin e komunës. Kanalet tjera të komunikimit, sidomos ato mediave sociale, mund të përdoren në mënyrë më efektive.
- Kryetarët e Komunave duhet të sigurohen që vendimet e tyre që kanë ndikim në jetën e qytetarëve, janë të qasshme dhe mund të sigurohen çdo kohë në mjetet publike të komunikimit. Situatë më e keqe është me aktet e kuvendeve komunale. Në pajtim me kornizën ligjore, këto akte duhet të publikohen para hyrjes në fuqi.
- Komunat nuk kanë të hartuar një plan për të identifikuar aktivitetet për të cilat kërkohet bashkëpunimi me qytetarë dhe të hartojnë plan të veçantë vjetor për konsultime publike, i cili do të ishte pjesë integrale e planit vjetor të punës.
- Komunat nuk mbajnë në shënim se cilat janë kërkesat apo propozimet e publikut të cilat kanë qenë të dobishme për të forcuar qeverisjen e mirë në komuna.

REKOMANDIME

- MAPL-ja në bashkëpunim me zyrtarët komunalë kompetentë mund të ndërmarrin një nismë të harmonizimit të thellë dhe të rishikimit të njëkohshëm të Udhëzimit dhe Rregulloreve në fushën e transparencës dhe konsultimit publik.
- MAPL-ja në bashkëpunim me komunat duhet të rrisin përgjegjësinë e konsultimit nga niveli teknik – administrativ në nivelin politik – strategjik. Udhëzimi Administrativ duhet ndryshuar në këtë vështrim dhe duke vendosur edhe masat stimuluese apo sanksionuese, varësisht nga zbatimi i udhëzimit
- Komunat duhet të shtojnë intensitetin e punës së tyre në bërjen sa më transparente të aktiviteteve të zhvilluara dhe dokumenteve publike. Komunat duhet të krijojnë mekanizma ligjorë, që qytetarëve t’ua mundësojë të jenë sa më afër informacionit. Pikëpamjet e ndryshme të publikut japin mundësinë e vërtetimit të supozimeve të administratës, duke zhvilluar politika të bazuara në të dhëna reale. Para se gjithash, komunat kanë nevojë të rishikojnë kanalet e komunikimit dhe rishikimit funksional të brendshëm dhe MAPL-ja duhet të ndërtojë projekte të veçanta që të përkrah këtë proces përmes asistencës teknike.

- MAPL-ja si liderë i politikave lokale, duhet të punojë ngushtë me Ministrinë e Financave, që të sigurojë që komunat kanë autonominë e mjaftueshme për ndarjen dhe alokimin e resurseve në bazë të prioriteteve dhe nevojave të tyre dhe njëkohësisht të adresojë përgjegjësinë për zbatimin e konsultimit publik tek udhëheqësit e organeve komunale dhe të minimizojë përgjegjësinë në nivel teknik.
- MAPL-ja duhet të konsiderojë mundësinë e organizimit të kampanjave me qëllim edukimin qytetarë për ndikimin e tyre në procesin vendimmarrës, ndërsa për zyrtarët kompetentë, seanca për ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'i adresuar sfidat.
- MAPL-ja të fokusojë komunikimin në instrumentet dhe mekanizmat komunalë, përmes ndryshimit të legjislacionit përkatës dhe përmes ndihmës konkrete në fushën e promovimit të transparencës komunale. MAPL-ja në bashkëpunim me komunat, kanë nevojë të bëjnë një vlerësim të detajuar dhe varësisht nga rezultatet të bëjnë rishikimin e udhëzimit administrativ duke e vendosur institucionin e përgjegjësishë tek organet vendimmarrëse.
- MAPL-ja në bashkëpunim me Njësinë Harmonizuese në kuadër të Ministrisë së Financave, mund të organizojë një seri trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe duke vepruar kështu të rris transparencën që e mban qeverisjen përgjegjëse kundrejt publikut që paguan taksa dhe pret të marrë shërbime.

ANEX

Lista e dokumenteve

[GAP Indeksi i transparencës](#)

[Indeksi i transparencës në qeverisjen e komunave](#)

[KDI Transparometri komunal – Transparenca e komunave](#)

[Prokurimi i përliqur në komunat e Kosovës](#)

[Raporti i Transparencës janar – qershor 2021 MAPL](#)

Lista e shprehjeve

Llogaridhënia menaxheriale

Prezanton përgjegjësinë e menaxherëve për veprimet, vendimet, rezultatet dhe politikat, duke përfshirë administrimin, qeverisjen dhe zbatimin brenda fushëveprimit të pozitës, dhe detyrimin për të raportuar, shpjeguar dhe përgjigjur në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet, kohën dhe buxhetin, ndaj organit, i cili i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë.

Lidershipi

Synon mobilizimin e njerëzve për t'u përballur me problemet e tyre dhe vendimmarrjet e vështira, si dhe për të mësuar mënyra të reja veprimi dhe me mobilizimin nënkuptojmë motivimin, organizimin, orientimin dhe drejtimin e vëmendjes kundrejt një objekti që mbetet krijimi dhe fuqizimi i vlerës publike.

Politika lokale

Politikat lokale iu referohen të gjitha nismave dhe veprimeve të autoriteteve lokale që synojnë përmbushjen e mandatit të organeve të komunës dhe që kanë të bëjnë me të gjitha llojet e planeve administrative, materialit strategjik dhe operativ, dokumentit kryesor buxhetor, planeve hapësinore dhe rregullative, udhëzuesve dhe doracakëve të cilat përdoren në procesin administrativ të Kryetarit të Komunës apo Kuvendeve Komonale dhe që rezultojnë me interes publik.

Aktet juridike

Akte juridike të komunës janë akte normative të karakterit të përgjithshëm apo të karakterit të veçantë që vendosin një normë apo prodhojnë një efekt në veprimtarinë e administratës lokale dhe që parashihen me legjislacionin primar.

Standardet minimale të konsultimit

Janë rregulla procedurale minimale, që kanë për qëllim zhvillimin e konsultimeve publike efikase gjatë procesit të hartimit të politikave dhe akteve nënligjore nga komunat, me përfshirje të palëve të interesuara dhe qytetarëve, pa plotësimin e të cilave procesi i hartimit nuk konsiderohet i plotë, përveç nëse parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi.

Konsultim publik

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes, me qëllim të marrjes së opinioneve, sugjerimeve, kërkesave dhe vërejtjeve të tyre, gjatë zhvillimit të procedurave të hartimit të politikave, dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore të kuvendit të komunës.

Palë e interesuar

Person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe subjekte të tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes.

ⁱ Kushtetuta e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

ⁱⁱ Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale, 15 tetor 1985, https://en.ëikipedia.org/ëiki/European_Charter_of_Local_Self-Government

ⁱⁱⁱ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, 4 qershor 2008, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

^{iv} Ligji për Qasje në Dokumente Publike, 30 maj 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

^v UA nr.06/2018 i MAPL-se për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18425>

^{vi} Rregullore (MAPL) nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, me datë, 23.08. 2017, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15184>

^{vii} Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkionimin dhe Bashkëpunimin me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>



Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +383 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com